

**DIONIS BUBANI**

BIBLIOTEKA

GJIROKASTËR

**ZGJIDH  
E  
MERR...**



E  
7SH-1-7  
B-88  
SHETIT

891-983-1-7

BSH-1-7

B-88

DIONIS BUBANI

# ZGJIDH E MERR...

(Poezi humoristike)

LIBRERIA E SHTETIT  
PRISHTINE

2014

~~53/88~~

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

8-1-888-108

8-1-1128

8-88

Piktor: BARDHYL FICO

14 3102 3 001  
1978 08 07  
D.K.K.  
~~8-88~~


LIBRARY OF THE UNIVERSITY OF TORONTO

## E MORE VESH?

Medet, u prish foleja,  
për riparim u mbyll një muaj kafeneja.  
Shëtitët të kërkonit një të re  
dhe gjetët, më në fund, një klub të qetë,  
ku u fundosët në kolltuqe dhe  
vazhduat thashethemet vesh më vesh:  
— E more vesh?

Ndryshoi lokali, por jo muhabeti.  
Në mes të dy filxhanëve me kafe  
shkëmbyet aqë shumë llafe,  
sa që parakaloi tërë qyteti  
me ndarje,  
me gradime  
dhe me huqe,  
ndërsa të shtrirë në kolltuqe  
caktonit kuadrin vesh më vesh:  
— E more vesh?





Papritur veç një ditë  
u mbyll dhe klubi për një ekspozitë  
dhe, pasi ju i ratë qark pazarit,  
i ratë edhe qarit!  
Gjetët një zyrë me një shok  
të etur për «të reja» ...  
Si u bashkuat të tre tok,  
hyri në zyrë kafeneja!

Pra s'ka fort rëndësi lokali,  
mjafton të gjesh  
atë që të dëgjon:

... E more vesh?



## QILIMI FLUTURUËS

Këshilla lart e poshtë po shpërndan,  
se ke lexuar shumë dhe di shumë,  
me zë të fortë përsërit revan,  
plot frymëzim,  
dispensat që vërshojnë si një lumë...  
Fjalët e urta bredhin pa pushim  
dhe i shqypton siç e kërkon autoriteti.  
Kush të dëgjon le të habitet në fillim,  
të mbetet gojëhapur nga sikleti...

Mendon:

*«Me shkencën s'bëhet dot shaka,  
do tru special sikundër që kam unë,  
prandaj, në mos kuptofshin dot gjithshka,  
nuk jam fajtor për këtë punë!»*

Të duket vetja se po ngjitesh vazhdimisht  
mbi librat që dikur ke konspektuar.  
Të tjerët mbetën larg, në bisht,  
në këto kushte, natyrisht,  
nuk ke durim për t'i dëgjuar!



Një fletë libri shndrohet në qilim,  
hipën mbi të dhe nisesh fluturim  
si në përrallë.

Por era shkund fletët e thata, miku im,  
a ke menduar ku do biesh vallë?

## NUK PINTE UJË...

Me nga dy norma për çdo ditë  
prodhuan shumë çizme përmbi plan.  
«Sukses i madh — menduan. — Kush na mban  
tani që do të dalim n'ekspozitë!»

Por kot u bë për tejkalimin bujë,  
se gjatë provës çizmet futën ujë...

Do ngjiteshin sërishmi nga fillimi  
të rregullohej cilësi e shkretë...  
Gjersa po pinin ujë çizmet vetë,  
nuk pinte ujë më justifikimi!

## KURBANI

Në një lokalitet,  
porsa u hap themeli i shtëpisë  
dhe shishja e rakisë,  
s'u ther një dash,  
por vetëm një... gjeldet.  
Dhe shokët e pushtetit  
festuan therjen e gjeldetit  
si një fitore  
madhështore,  
se... nuk u prekej fort as pasuria!

Dhe pinë shokët deri vonë.  
U derdh pak gjak, si urdhëroni,  
por u zhduk dashi përgjithmonë,  
mbeti vetëm gjeldeti dhe... zakoni!

## B E D E L I

Po dridhte një duhan  
i shtrirë nënë hije.

— Pushim të mbarë, Ramazan!

— E mora vesh se ku ma hedh, shejtan,  
por sot punon për mua ime bije. . .

Pas gjashtë muaj çupa u martua,  
tjetër fëmi' nuk ka, as grua,  
dhe Ramazani po aty, më nge.

— Sot kush punon për ty, a nuk më thua?

— A e shikon atje

gomarin që po niset i ngarkuar?

Është veshgjati im,

punon për mua

pa përtuar

dhe brigadieri ma shënon ditën qesim!



Sikur të kishte gojë ky gomar  
në kryesi fyshek do shkonte:

— Kryetar,  
si po shënohen këto ditë në hava?  
Dikush punon e tjetërkush po ha!

## DJEMTË E TYRE...

Tha i pari: — «Ime bije  
lëviz vinçin sikur lot...  
Unë s'do ta bëja dot,  
por rinisë i ka hije...»

Aq e vogël në kabinë  
po më duket kur punon,  
shtyp një sustë, marshin ndrron  
dhe ngre peshat pa e prishur terezinë...»

Tha i dyti:

«— Vajza ime, aq e ëmbël dhe e mirë,  
drejton tanksin me guxim.  
Dridhen kodrat që n'agim,  
kur lëviz tok me kështjellën mbi zinxhirë...»

«— Çupa ime që më dukej aq e butë  
— tha i treti, — sot po hipën gjer në re,  
dhe pa frikë që atje  
fluturon me parashutë!»

... Fluturon, ngjitet ndër kodra dhe ngre pesha,  
po mendonin baballarët:

«— *Lum si na!*»

Nuk rënkonin si dikur se sot ata  
s'kishin djema. . .

Kanë vajza dhe burrnesha!

## MAÇOKU KONSERVATOR...

I tha maçoku maces: — Po e tepëron...  
Tani që u martuam ne, e dashur grua,  
nuk duhet të këndosh «miau-miau»... Dëgjon?  
Miau-miau përjashta nukë dua...

Nuk jam konservator, por s'ka lezet  
të hipësh majë çatisë  
porsi në vitet e rinisë...  
Dikush mund të mendojë me të drejt'  
se ndoshta, kur jam me shërbim, ti në mesnatë  
i bën dashnorit serenatë!

— Të paska zën' virusi i xhelozisë —  
ja priti macja, — mjerë ai që e kap...  
— Do të kopjoj të zotin e shtëpisë,  
gruan s'e lë të bëjë xhap!



## SHËMBULLI PERSONAL

U ul në tavolinë hundë e buzë,  
përpara kish tenxheren me fasule:

— Pse, vetëm groshë kemi sot për drekë?

Ja priti gruaja:

— Të lutem, zërin ule...

— Mojt, je në vete, dashke të mos flas?

Më hipën xhindet dhe do çirrem

do bërtas,

është duhet respektuar tavolina,

të ketë kalori


dhe vitamina...



— Tenxheren e ke plot deri në majë...  
Mos u mërzit... Prej teje u mësova,  
prej shëmbullit tënd personal,  
të mos çaj kokën për asortimente,  
ta realizoj planin vetëm... global!

~~SECRET~~  
**INFORMACIONE E SHKURTUARA**  
KONFERENCA E SHKURTUAR

20/147





## FLAKË KASHTE

Qëndruam fushës dhe vështruam me habi:  
një zjarr i madh ish ndezur jashtë.  
Po digjej kashta vrullshëm si çdo kashtë  
dhe flakët ngriheshin përpjetë me furi,  
sikur po digjej Troja e lashtë,  
por ja, pas pak çdo gjë mbaroi në hi.

«Sa shpejt u shojt ky zjarr, çudi!»

Dhe shoku im ra në mendime,  
më tha ngadal':

— Nuk di si ndodh tek ju,  
por më kujtoi ky zjarr disa zotime,  
që shpesh, tek ne, mbarojnë po kështu!



## FORMALISTI...

Përmendsh i di tërë përkufizimet,  
dhe numërin e faqes ta thotë pa ngurrim.  
Kujtesën e ngacmojnë frymëzimet,  
në maj' të gjuhës: një përkufizim!

Po ta pyesësh:

— *Si je me shëndet?*


të thotë:

— *A e di ç'është shëndeti?*

Vazhdon përkufizimi shpejt e shpejt,  
se pa përkufizim  
nuk ka kuptim  
as muhabeti...

Sot «teorikut», që grin pa pushim  
(se nuk shteroka kurrë verbalizmi),  
i mbeti vetëm një përkufizim  
pa zgjidhur:

— *Ç'është formalizmi?*



## FRIKAMANI

Ka plot gjëra për të thënë,  
më në fund do ta dërmojë,  
do të ngrihet si luan;  
do të flasë i vendosur  
sot o kurrë...

Por s'ja mban!

Le të ngjasë, pra, ç'të ngjasë,  
tek e fundit çdo t'i bëjë?  
Do të flasë një sahat.

Kur ke fakte, ja mbyll gojën,  
e mbërthen...

Por s'ka takat!

Se në shesh të del e drejta,  
si del vaji sipër ujit,  
kur je burr' me karakter.

... Por u mbyllën diskutimet,  
do të ngrihet tjetër her'!



07-29

## IRONI E FATIT...

Lisat për shtylla elektriku  
i preu,  
se furra donte dru.  
Përtonte  
që të shkonte  
pak më tutje,  
prandaj sëpata nuk dëgjonte  
lutje,  
priste me vrull  
majtas,  
                  djathtas këtu.

Mendonte pylli:  
— Ironi e fatit!  
Do mbanim telat ne  
me krenari,  
do të përhapnim dritën elektrike,  
kurse tani  
do të ndriçojmë vetëm furrën,  
ku do të dërgjemi pas pak në hi!





## ME DY ÇERDHE...

U kthyen dallëndyshet, ndërtojnë një fole,  
me vrull të madh punojnë nënë streh  
dhe, pas çdo fluturimit,  
shkëmbejnë ndonjë fjalë në afsh të frymëzimit:

— E dashur, ja, e ngritëm çerdhen tonë,  
të lumtur do jetojmë së bashku përgjithmonë,  
përherë të pandarë,  
jo si disa që, ndoshta, s'i merr malli  
dhe ndahen për së gjalli.  
Sot, duke fluturuar,  
o shpirti im, kam parë  
burra të transferuar,  
që rrojnë si beqarë.  
Na paskërkan dy çerdhe, si më thanë,  
se gratë nuk i marrin, i mbajnë në Tiranë!

## I PARI DHE I FUNDIT ...

Me zell të madh broshurat konspekton,  
përmendsh vendimet i mëson  
dhe flet aq bukur, sa të kam zili.  
Çdo ditë mund të mbash nga një leksion.  
Nuk ta kalon njeri në teori.

Kjo është e vërteta, pra, dhe pikë.  
Por ti i fortë je dhe në praktikë,  
kudo di ta tregosh shpesh zotësinë,  
ta lidhësh me praktikën teorinë.

Parullat i zbaton  
i pari në ndërmarrje.  
Për shëmbull, ti kërkon  
që të jetosh kudo pa kokëçarje.  
Ti je i pari për jetesën më të mirë,  
i fundit në çdo punë të vështirë.

Pra një ndryshim pa shumë rëndësi  
dhe në praktikë, jo në teori!



« SHPIRTMIRI » ...

E gjen shokun duke fjetur  
në një qoshe të repartit, mu aty,  
por ka halle turni i tretë...  
mbyll një sy.

Të kërkon leje një orë  
dhe mungon pastaj nja katër,  
përsëri e ke në dorë  
që ta mbash nga pak me hatër...



Rrijnë kot, pa punë, presat,  
por s'prish gjakun, meazallah,  
rrallë i shënon mungesat,  
lum ndërmarrja që të ka!

Ty të thonë:

«Sa shpirtmirë!»

Ti i thua rendimentit:

— Lamtumirë!



## HUMBJA M'E MADHE ...

Fillonte më në fund seanca e parë  
me dymbëdhjetë dëshmitarë.  
Gjykata, sipas ligjit në fuqi,  
do bënte drejtësi.

T'ju them tani  
se ç'kishte ngjarë:  
një mushkë e Grumbullimit,  
me një goditje si rrufe,  
kish nxjerrë jashtë qarkullimit  
gomarin e simotrës NBSH-e...  
Për këtë krim  
kërkonte NBSH-ja dëmshpërblim...

Por çështja s'ishte aq e letë,  
prandaj vazhdoi seancë e dytë dhe e tretë.  
Disa e mbronin mushkën,  
ca gomarin;  
kujt do t'ja ndreqnin vall' samarin?

Procesverbali thosh:

«Ditën e martë,  
rreth orës tre»... Më tej nuk ish i saktë,  
fatkeqësisht,  
nuk e shpjegonte hollësisht  
qysh ishte vrar' gomari i mjerë,  
në bark,  
në gjoks,  
apo në tru...

Si thoni ju,  
mund të vendosnin kuturu?  
Prandaj gjykata, si u mblodh nja katër herë,  
unanimisht  
vendosi pezullimin  
e çështjes gjyqësore  
për shkaqe parimore,  
por e njoftoi NBSH-ënë se apelimin i  
pas dhjetë ditëve, me shkrim të qartë,  
mund që ta bënte në Gjykat' të Lartë!

Dhe dëshmitarët që erdhën vërdallë  
në gjyq, ku bënë edhe be,  
menduan të kapitur:

— Kush vlen vallë  
më fort, gomari apo ne?  
Orët që humbëm kanë vlerë  
sa një kope  
me kriça dhe gomerë!

## MË THONË SE JAM PA INISIATIVË...

Më thonë se jam pa inisiativë...

Po pse, ç'detyrë m'u ngarkua nga të tjerë  
dhe nuk e kreuva menjëherë?



## BLERËSI DHE PRODHUESI...

Desh që të blente një këmishë,  
por ishte qepur për ibret  
dhe blerësi, me plotë të drejtë,  
shitset i tha:

— Habitem si e shet!

Vazhdoi t'i tregonte dhe përse  
nuk do ta blente mallin kurrsesi.  
Vrejtje me vend...

Por ja se një kliente,  
që ndodhej aty pran', i tha: .


— E di

se ti të drejtë ke përse ankoresh,  
o shoku qytetar, por mos harro:  
këpucët që m'i bëre, pas një jave  
m'u shqepën...

I punove shkel e shko!

I njëjti je,  
por oh, sa fort ndryshon  
kur rolet shpejt e shpejt i ndrron!  
Si blerës fole kiamet  
dhe me të drejt',  
por si prodhuës hesht dhe heshtja... flet!





## HUMBJET...

Ashtu ndodh shpesh kur mban diçka në dorë,  
të fshihet krejt papritur,  
të mundon.

... Të humbi shkrepnja, e kërkon  
dy orë,  
të humbën kot dy orë, s'i kërkon...

## PARULLA

Magazina ishte mbushur gjër në majë,  
por përgjegjësi mendonte:

— Të kërkojmë nga Importi përsëri!

Le të ndodhen si rezerva  
se askush nuk do t'i haje,  
po të kemi,  
jemi brenda:


*marifet me leverdi!*

Dhe që të mos hapej kurrë  
ajo portë,  
kish gozhduar nja tri drrasa urgjentisht  
mbi të cilat kishte shkrojtur  
një parullë:

«Të kursejmë,

të kursejmë,

të kursejmë vazhdimisht!»



### MERITA...

— Kot po shtyhen, se kuvertat  
dolën skarco fare,  
për mendimin tim nuk vlejné  
asnjë pare...

Ja, u bie pushi,  
prishen në një muaj...

— Ndoshta janë skarco,  
por skarco e huaj!



## F R Y M Ë Z I M

Shikoj oxhakë dhe shtylla tensioni,  
lart hekura ndër skelet pa mbarim,  
ku po rrëshqet me frymëzim  
betoni,  
që çimentohet si ky vargu im...  
Kudo një pamje e lumtur po më del,

shikoj çelik,  
          bronx,  
                  hekur  
                          dhe nikel,

traktorë,  
          vinça,  
                  buldozerë në mëngjes,  
që përshëndesin një ekskavator...

— Shoku poet, vështro më me kujdes,  
nuk duket asnjë punëtor?



## NE DHE TI...

Ne mbjellim grurë, misër, qepë, presh,  
sipas kërkesave të bujqësisë.

Ti mbjell vetëm dafina që t'i kesh  
për vete si kurora të lavdisë!



## I MIRI DHE I KEQI ...

— Patëm një arsimtar këtu në fshat,  
njeri i thjeshtë, i gotës dhe i gazit,  
emrin e kish Murat,  
nuk shiste mend, na shkonte pas avazit. . .

Flinte si ne  
përdhe,  
hante në një sahan, pa salltanete,  
gëlqeren s'e përdori as për vete,  
dhe rrinte i parruar  
të mos na shiste mendjemadhësi.  
Pra, shkurt hesapi, ku na kish qëlluar,  
tamam me porosi! . . .

Ç'e do veç, se mjerisht është larguar,  
një tjetër erdh' në vend të tij. . .

Për nder, të mbetet midis nesh,  
ky s'na honepset fare. . .  
Seç ngatërron, ve vazo në dritare,

i lan çarçafët shpesh. . .  
Na zuri taksirati,  
se na u shpif krevati. . .  
I lyen muret me njëmijë marifete,  
dhe sot e mori vucën përsëri,  
le që shet mend për vete,  
por na fut hundët dhe në çdo shtëpi. . .

— Ta paska sjell' në maj' të hundës arësimitari,  
se nuk u shtrua si i vjetri.  
T'uroj mos qofsh kurrë i mirë si i pari,  
i keq u bëfsh përherë si ky tjetri!



## G Ĕ Z I M I   Y T . . .

S'të kisha parë kurrë  
më të gëzuar dhe më optimist,  
shoku artist!

Kujtova në fillim  
se ky gëzim  
rrjedh prej një roli të vështirë  
që ndoshta kishe realizuar me sukses,  
por s'ish kështu. . .

Kujtova se ke pirë  
për ndonjë mall të vjetër  
q'u rindez,  
por s'ish kështu. . .

Kujtova se ke ngritur  
dollinë për një pjesë dramatike  
me vlera të veçanta artistike,  
por s'ish kështu. . .

Dhe ika i mërzitur,  
më erdhi keq, s'do mend,  
kur mora vesh se qeshje dhe këndoje,

me krenari festoje  
dështimin e kolegut tënd!

Kuptova, atë çast, se dhe dështimi  
mjerisht ndodh që shpërndan rreze gëzimi!

## S U S !

Një mizë i tha shoqes:

— Eja edhe ti

në shkollën përkarshi,  
ku jep mësim shoku Sali. . .  
Aty ka qetësi të plotë  
si ndoshta n'asnjë tjetër vend në botë,  
do të dëgjohemi për bukuri,  
se nxënësit, nga frika t'edukuar,  
sikur as frymë s'marrin  
të tmerruar,  
të mos e shqetësojnë arsimtarin. . .  
Në klasë shpesh shoku Sali,  
i nxirë në fytyrë pus,  
sipas pedagogjisë së tij  
u thotë:

— Do të më zënë krizat,  
po të mos rrini sus,  
sa të dëgjohe. . . mizat!



## I PAKËNAQURI

— Përse nuk e mësove poezinë?

Ti meriton një katër këtë her' ...


— Nuk më pëlqen se thoshte:

«Kur do rritem,  
do bëhem o doktor, o inxhinier!»

Ndoshta dua të bëhem murator,

pilot, gjeolog, shofer o minator!

Xhaxhi, që shkruan, përse nuk na pyet  
se ç'dëshirojmë ne në të vërtetë?



### PËR NË SPITAL ...

Autobusi s'kish arritur në stacion,  
por udhëtari desh të zbriste i nxituar.  
I tha dikush:

— Prit, se nuk ka ndaluar...

— E di, por më vonon  
dhe dua të shkoj sa më parë në spital!

I hapi rrugën miku:

— Po qe kështu, më fal,  
udhë të mbarë,  
bujrum, kalo se s'të ndalon njeri,  
hidhu, pra, sa më parë  
se në spital do shkosh me siguri...


## ÇUPKA E MAMASË...

Bie një kopsë, griset një çorap,  
ka aqë të papritura në jetë,  
por ti, mjerisht, gjilpërën dot s'e kap,  
nuk di si futet peri, moj e shkretë!  
Nuk di të lash një plaçkë, moj Burbuqe,  
por di t'i lyesh buzët me të kuqe,  
t'i heqësh vetullat, ashtu siç të pëlqen,  
t'i lyesh flokët shpesh me oksigjen,  
një okë zhivë di t'i vësh fytyrës  
edhe të rrish shtat' or' para pasqyrës!

E di,  
t'i bënte nëna punët në shtëpi,  
ti s'laje asnjë drrasë,  
të vinte zor  
të hapje petët për lakror,  
si çupkë e përkëdhelur e mamasë!

Por sot, siç e tregon dhe jeta,  
lakrorit i del peta...





## QËNDRIMI «PARIMOR» ...

Për veprën e një mikut tënd të dashur,  
që ndoshta s'vlen një grosh,  
nuk do kursesh as letër dhe as bojë  
t'i dalësh para opinionit, si mburojë,  
dhe me çdo kusht ta lavdërosh!

Për veprën e një tjetrit, që të duket  
antipatik, se nuk mund ta durosh,  
nuk do kursesh as letër dhe as bojë  
të tallesh me pasion, ta vësh në lojë  
dhe me çdo kusht ta bombardosh!

Në dorën tënde pena, mor jahu,  
qenka dafinë ose hu!

## DEMBELI...

Dembeli tek po rrinte shtrirë  
(prej shekujsh, siç e ka zakon),  
kur pa sahatin tha:


— «Ky e ka mirë  
se ecën, por në vend qendron!»



## ZBRITE MENJËHERË PESË...

Je materialist, e di,  
ateist i bindur;  
gjer më sot askush s'ka lindur  
më përparimtar se ti.

Muhameti shtatë la,  
ti i shpalle luftë fesë,  
zbritë menjëherë pesë,  
mban vetëm dy gra!



### DASHURIA E TYRE...

Çifti kaioi para nesh  
folë e qesh...  
Buzëqeshnin me embëlsi...

— Dashuri e rrufeshme  
qysh në shikimin e parë, me siguri!

— Jo, dashuri  
në shikimin e dytë,  
sepse herën e parë s'e pa me sy kritikë,  
nuk dinte se kish nusja prikë!

## ZGJIDH E MERR...

Më tha:

— *Ti mund të zgjedhësh, miku im,  
mes dashurisë e bukurisë...*

Dhe unë pa ngurrim  
rrëmbeva bukurin' e dashurisë!



## K U S H T I


Thirr shoqe sa të duash në shtëpi,  
leshverdha dhe zeshkane,  
dhe bëni sa të doni gjurulldi,  
se ç'i kuptuam ne kësaj jallane?

Kërceni, qeshni, bëni muhabet  
dhe deri në mesnatë.  
Gostiti shoqet me biskota në shërbet,  
potë ju teket pini limonatë...

Prej meje ti s'ke asnjë kundërshtim.  
Jam bashkëshort model, e dashur grua,  
po t'erdhën shoqet e ndërmarrjes, aferim,  
t'i presësh, vetëm shokët nuk i dua...

Të lutem, mua ti mos më shiko,  
se është fare ndryshe puna ime...  
Jam, tek e fundit, mashkull, apo jo?  
Me femra mund të rri pa shqetësime...

Por ti je grua, s'di a më kupton,  
je femër, moj, edhe të dalin llafe.




E lirë je, për shëmbull, se punon,  
por s'bën të ulesh, si ne burrat, në një kafe...

Më duket se të flas mjaft njerëzisht,  
ja, të lejoj të shoqërohesh (por kujdes se e di  
vetë)

me shokët që u lindën afërsisht  
në shekullin nëntëmbëdhjetë!





### K T H E S A . . .

— Shikoje Peçin: burrë ideal,  
po shkund qilimet përsëri  
dhe pikë pluhuri nuk lë, se i godet  
me mjeshtëri!

— S'e lot as topi, Peçi bëri kthesë;  
që kur dëgjoi për emancipimin,  
s'ja mban të rrahë gruan si përpara,  
tani godet, me duf, vetëm qilimin!

## T'U TRASHËGOFTË VAJZA . . .

T'u trashëgoftë vajza . . . pastë fat,  
Qoftë martesë, pra, me këmb' të mbarë,  
por ti mos u mërzit . . . Çdo taksirat  
kalon me kohë . . . Ja, ke për ta parë!

Ajo të iku larg dhe, me sa di,  
sikur të hapi një greminë.  
Ah, kur bën vajza dashuri,  
mjerisht harron dhe prindët dhe shtëpinë!

E la qytetin dhe shkoi në katund . . .  
Do t'isha çmendur të më ndodhte mua.  
Më kot po e vras mendjen, po nuk mund  
që të kuptoj se si u dashurua.

Jot bijë ish me shkollë, pa dyshim,  
kish mjaft kërkesa dhe ish vajzë e pjekur,  
prandaj çuditem për këtë qëndrim,  
por ti mos psherëti, se s'të ka vdekur . . .

Si the? Ti je e lumtur? Ç'thua, moj?  
Po kush të tha se bëri ajo gabime?  
Shyqyr që mori atë që dashuroi,  
dhe unë sot të erdha për urime. . .



## DATAT E SHËNUARA

Vështronte kalendarin me kujdes,  
bënte dhe krahasime,  
studjonte datat, mbante shpesh shënime,  
tregonte aqë shumë interes,  
si shkencëtari i zhytur në studime...

Dhe buzëqeshte i kënaqur ndonjëherë  
ashtu, papritur,  
për një zbulim me shumë vlerë  
pas mjaft përpjekjesh të arritur:

kish vënë re se binin, rastësisht,  
hem një janari e dhjet' korriku,  
kur ishte dhe bajrami pikërisht,  
pra me një gur vriste dy zogj ky miku.

Do therej qengji dhe do piqej bakllavaja  
si ndër vitet e shkuara, —  
kush mund të flasë për shpenzimet e mëdhaja  
kur janë data të shënuara?

## BILANCI I NJË DITE...

Në korridor dëgjohen çape:  
kolegët kthehen në shtëpi.  
Pa zhurmë, sikur ecën në çorape,  
ngrihesh i fundit edhe ti,  
qëndron një çast në mes të zyrës,  
i flak tej rrudhat e fytyrës  
dhe i fërkon duart e buta:  
—Shyqyr, kaluan dhe këto minuta...

Ti ndihesh i kënaqur, i përpiktë,  
se po del fiks në orën e caktuar,  
mbyll derën me vullnetin e çeliktë  
që asnjë çast s'të ka munguar,  
vulos në zyrë, me kujdes, dy thashetheme,  
një telefon që çlodhet i kapitur,  
(se përmes tij zvarris kaqë probleme,  
ndërsa i lë të tjerët duke pritur...),  
Ti kyç dy zarfe të panisura,  
katër pusulla miqësore, tri lëshime,

koncepte gabimisht të grisura,  
hutime,  
sorollatje,  
    ëndërrime  
në dritare  
dhe një dremetje thjesht zyrtare!




## JANË HALLE DRAMATIKË...

Për pjesët teatrale  
(nga frika se mund të gabosh)  
ke shpikur një metodë ideale:  
i hedh toptan në kosh.  
Kështu je brenda, s'e çan kokën fare  
kur i lot veprat vetëm ndër sirtare!

Ti dashke që të flesh i qetë  
prandaj merr masa sigurimi,  
por mos vazhdo që t'i shtosh vetë  
(as kur të kap pas mjekre frymëzimi)  
dy akte, tetë personazhe  
sikur qenkan pjesë këmbimi  
me ingranazhe...

Përse ngre supet? Marifetin e ke bërë  
me veprat e Marikës, të Veliut...  
Por nuk u bëka arti me gërshërë  
duke u dridhur si në polin e veriut...



Pa le pastaj kur të pushton  
një shqetësim i pandërprerë.  
Por sa shikon  
një ëndërr urdhëron  
të ndrrohet mizansena menjëherë...

E ndrron dekorin,  
regjizorin,  
e më në fund dhe autorin,  
se tekstin (si do që të jetë)  
e shkruan njëqind herë më mirë vetë!

E di  
se pa intrigë s'ka dramaturgji,  
çdo pjesë pa intrigë duket kashtë,  
por mos beso  
gjuhën e ligë,  
mjafton në skenë një intrigë,  
prandaj mos u mundo  
që ta shpërthesh intrigën jashtë!




## AUTOKRITIKA

Do të ngrihej para klasës punëtore,  
sinqerisht do të fliste, pa dyshim,  
me një autokritikë të hapur dhe parimore. . .  
ishte plotësisht dakord, por shkoi me shërbim. . .

Shërbimi dhjetë ditë zgjati.  
U kthye i vendosur që t'i fliste klasës punëtore,  
dhe çdo gjë ishte gati,  
kurrë iu desh që të merrte lejen vjetore.

Pas pesëmbëdhjetë ditëve iu dëgjua përsëri zëri,  
kur u paraqit në punë dhe pa ngurrim  
caktoi dhe datën e autokritikës, por nuk e bëri  
se nisi muaji i punës në prodhim.


Dhe pas punës fizike një ekip i doli,  
pastaj e dërguan në terren.  
Autokritikën e mban në xhep, por ja se ç'i polli:  
një ditë të lirë nuk gjen!



## PSEUDONIMI

Mbi ekonominë e vendeve revizioniste  
zgjerohen metastazat e kancerit,  
mpleksen me dhimbjet e krizës kapitaliste  
si dikur vuajtjet e Musolinit dhe të Hitlerit. . .

«Këshilli i ndihmës ekonomike reciproke»  
nuk mund të quhet troç K.A.N.C.E.R.-i,  
prandaj u gjet një pseudonim për ekonominë  
uloke,  
kështu lind me dy gërma më pak K.N.E.R.-i!



## BARAZI...

— Të dashur shokë, kurdoherë  
besoj se jeni mjaft të qartë:  
pavarësisht se kam më shumë vlerë,  
ne jemi sot të barabartë...

Rroj në Kremlin dhe di diçka më shumë,  
por nuk e hani edhe ju të thatë...



Të më shikoni mua dhe në gjumë,  
të më dëgjoni mua ditë e natë...

Pra kini mendjen, mos më kundërshtoni,  
ne jemi miq të vjetër, të pandarë.  
Jeni të lirë që të aprovoni  
çfarë vendosa unë pak më parë!

## NË MBLEDHJEN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS.

Në mbledhjen e traktatit të Varshavës  
mbushen topat dhe zbrazen kuletat,  
është e përsosur dishiplina ushtarke,  
sipas komandës po votojnë marionetat!

Çdo agresion vullnetarisht pranohet  
si ndihmë internacionaliste që të forcohet pushtetit  
Kryekomandanti carist, po të ngrihet në këmbë,  
do të thotë se u arrit unanimiteti. . .

Ndoshta atë çast dhe Pakti i Atlantikut  
mblidhet që të shqyrtojë planet perspektive.  
Ndryshon vetëm dialekti i tyre,  
mbetet e njejtë gjuha agresive!



## HALL TË RROSH, HALL TË SËMURESH.

Hall të rrosh, hall të sëmuresh  
atje në... «*Botën e lirë*»...  
Shkon te mjeku dhe të thotë:  
— Mishi, gjalpi të bën mirë!

Por këtu dalin avazet...  
Qysh t'ja bësh ti, pa më thuaj?  
Se, që të paguash mjekun,  
s'duhet që të hash një muaj!



## HALLI I MINISTRIT TË KOLONIVE.

Jam ministri më fatkeq,  
kujt t'ja prish e kujt t'ja ndreq...  
Mbretëresha ndër sallone  
më kërkon shpesh relacione,  
se si shkojnë kolonitë,  
që po treten për çdo ditë...

Mbaju, moj perandori,  
se iu pre bishti luanit,  
ne për ty po mbajmë zi  
kur coptohesh jashtë planit!  
Ministria ime e gjorë  
seç po tretet për çdo orë,  
porsi kripa n'ujë tretet,  
vetëm emri do t'i mbetet!

Ma ndjen zemra se dhe unë  
do të mbetem shpejt pa punë!

## EMËRTIMI I RI...

*Në Angli fabrikohen pizhama prej letre, të cilat përdoren vetëm një natë.*

— gazetat —

Përderisa i mbajnë veç një natë  
dhe tej i flakin  
pizhamatë,  
mund që t'i quajnë,  
për hir të cilësisë:  
premtime të qeverisë!



## PIKTURA...

Piktori futurist në Amerikë  
i kishte ngritur çmimet me të parë  
se ishte shtuar klientela,  
por një djalosh, si e vështroi pikturën,  
i dha vetëm katër dollarë...

I tha piktori i xhindosur:  
— Je çmendur, apo hiqesh si i marrë?  
Qysh më jep katër për këtë pikturë  
plot frymëzim të pastër prej artisti  
kur vetëm bezja vlen njëzet dollarë?  
Në rast se s'paske pare, mor i shkretë,  
mos i fut hundët ku s'ta mban!

Ja priti miku:

— Ndoshta mbi njëzetë  
vlente kjo beze kur ishte e pastër,  
tani t'i jap dhe katër me pishman!



## PASQYRA E LENËS

	Faqe
— E more vesh? .....	3
— Qilimi fluturues .....	7
— Nuk pinte ujë .....	9
— Kurhani .....	10
— Bedeli .....	11
— Djemtë e tyre .....	13
— Maçoku Konservator .....	15
— Shembulli personal .....	16
— Flakë kashte .....	19
— Formalisti .....	20
— Frikamani .....	21
— Ironi e fatit .....	23
— Me dy çerdhe .....	24
— I pari dhe i fundit .....	25
— Shpirtmiri .....	26
— Humbja m'e madhe .....	28
— Më thonë se jam pa inisiativë .....	30
— Blerësi dhe prodhuesi .....	31
— Humbjet .....	32
— Parulla .....	33
— Merita .....	34
— Frymëzim .....	35
— Ne dhe ti .....	36
— I miri dhe i keqi .....	37
— Gëzimi yt .....	39
— Sus .....	41

— I pakënaquri .....	42
— Për në spital .....	43
— Çupka e mamasë .....	44
— Qëndrimi «parimor» .....	46
— Dembeli .....	47
— Zbrite menjëherë pesë .....	48
— Dashuria e tyre .....	49
— Zgjidh e merr .....	50
— Kushti .....	51
— Kthesa... ..	54
— T'u trashëgoftë vajza .....	55
— Datat e shënuara .....	57
— Bilanci i një dite .....	58
— Janë halle dramatike. ....	60
— Autokritika .....	63
— Pseudonimi .....	64
— Barazi .....	65
— Në mbledhjen e traktatit të Varshavës .....	67
— Hall të rrosh, hall të sëmuresh .....	68
— Halli i ministrit të kolonive .....	69
— Emërtimi i ri .....	70
— Piktura .....	71

**LIBRARI E SHTETIT**  
**REPUBLIKAN**

53 366

Tirazhi 2000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-65

---

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970